



MEDIA, POLITIKA DHE REFORMA NË DREJTËSI

Monitorimi i ligjërimit politik
dhe mediatik mbi reformën

SHTATOR 2019 – MARS 2020



INSTITUTI I STUDIMEVE
POLITIKE

RAPORTI ËSHTË REALIZUAR NGA STAFI I ISP NË KUADËR TË PROJEKTIT
“SISTEMI I RI I DREJTËSISË: TRANSPARENCË DHE PËRFSHIRJE.
MONITORIMI I KLGJ, KLP, KED, KKR DHE LIGJËRIMIT PUBLIK”
MBËSHTETUR NGA PROGRAMI I REFORMËS NË DREJTËSI,
FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË.

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe të ISP.
Ato nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.



MONITORUES

Lisian Roseni

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2020

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

web: www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

**MEDIA, POLITIKA
DHE
REFORMA NË DREJTËSI**

MONITORIM I LIGJËRIMIT PUBLIK TË REFORMËS NË DREJTËSI

SHTATOR 2019 – MARS 2020

TIRANË, 2020

PËRMBAJTJA E LËNDËS

<i>HYRJE</i>	5
<i>GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT</i>	6
<i>SHTATOR 2019 - SHKURT 2020</i>	12
1. RAPORTIME NË EDICIONE LAJMESH	12
2. DEBATET TELEVIZIVE DHE INTERVISTA	13
<i>MONITORIMI I MEDIAVE ONLINE DHE GAZETAVE SHTATOR 2019 –SHKURT 2020: GJETJET DHE PROBLEMATIKAT</i>	15
1. MONITORIMI I MEDIAVE ONLINE	15
1.1 Muaji i Monitorimit	15
1.2 Raportime mbi reformën në media	16
2. QËNDRIMI I MEDIAVE	18
2.1 Qëndrimi i mediave në total	18
2.2 Qëndrimi mediatik (Media online)	19
2.3 Qëndrimi mediatik (Gazeta)	21
2.4 Qëndrimi i mediave (Media Online Vs Gazeta)	22
3. FJALIMET NË RAPORT ME REFORMËN NË DREJTËSI – SUBJEKTET LIGJËRUES	24
3.1 Subjektet ligjërues në të gjithë mediat	24
3.3 Subjektet ligjërues në mediat online	25
3.4 Subjektet ligjërues në gazeta	27
3. REFERIMI I LIGJIT NË LIGJËRIME	28
3.1 Referim i kuadrit ligjor	28
3.2 Karakteri i ligjërit	30
<i>REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME</i>	9
<i>DEBATET EKSKLUZIVE NË EMISONE TELEVIZIVE</i>	32

HYRJE

Instituti i Studimeve Politike (ISP) po kryen prej shtatorit 2019 e në vijim, monitorimin e aktivitetit të institucioneve të reja të drejtësisë, si dhe ligjërimit politik dhe publik në Shqipëri ndaj kësaj reforme. Angazhimi është pjesë e projektit të ISP “Sistemi i ri i drejtësisë: transparencë dhe përfshirje. Monitorim aktiv i KLGJ, KLP, KED, KKRD” mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Programi i Reformës në Drejtësi.

Ky studim finalizon fazën e katërt të raportit monitorues të ligjërimit mbi reformën në drejtësi. Ekipi monitorues i ISP ka grumbulluar të dhëna parësore në këtë studim të fundit nga një monitorim i vazhdueshëm dhe nxjerrje e të dhënave nga 4 gazeta periodike, 6 media online dhe 5 kanale televizive.

Konkretisht, monitorimi i ligjërimit politik dhe i raportimit është bërë në disa nivele:

- Në nivelin politik (deklarime të partive politike në nivel mediatik)
- Në nivelin e ekspertizës (deklarime nga ekspertë të fushës brenda e jashtë sistemit)
- Në nivelin mediatik:
 - media televizive “Top Channel”, “Klan TV”, “Vizion Plus”, “Ora News”, “News 24”,
 - media e shkruar “Panorama”, “Shekulli”, “Gazeta Shqiptare”, “Dita”,
 - portale online “Javanews.al”, “Politiko.al”, “Syri.net”, “Zëri i Amerikës” etj.

Të dhënat në këtë studim janë parësore, pra produkt i procesit monitorues. Ndaj dhe nuk janë referuar të dhëna të tjera dytësore. Këto të dhëna janë pasqyruar në mënyrë sasiore dhe interpretuar në funksion të ligjërimit mbi temën e reformës në drejtësi. Periudha e monitorimit ka nisur më 1 qershor 2018 dhe vazhdon ende edhe në vijim pas gushtit të 2019-ës. Raporti i parë i publikuar në shtator 2018 përfshin periudhën e monitorimit qershor – gusht 2018, ndërsa studimi i dytë përfshin periudhën shtator 2018 – shkurt 2019. Studimi i tretë përfshin periudhën mars – gusht 2019. Ndërsa studimi aktual përfshin periudhën shator 2019 – mars 2020. Studimi aktual është etapa e dytë e studimit të viteve 2019-2020. Studime të cilat janë ndarë në dy periudha. Si arsye se disa nga gjetjet e fazave të studimeve të mëparshme kanë pasur vlerë krahasimore, janë referuar edhe në këtë studim. Të gjitha studimet janë realizuar me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT

Ligjërimi politik e publik mbi reformën në drejtësi mbetet aktual në debatet mes eksponentëve partiakë, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në nivel mediatik mes ekspertësh, opinionistësh, përfaqësues të shoqërisë civile etj. Reforma në drejtësi mbështetet nga institucionet ndërkombëtare perëndimore dhe deklaratat e nxjerra nga ky studim tregojnë përkujdesjen e veçantë të tyre ndaj reformës. Ajo mbetet një nga treguesit më cilësor të zhvillimit institucional dhe progresit demokratik të Shqipërisë. Reforma në drejtësi është përshëndetur nga ndërkombëtarët, jo vetëm si një sukses në nivel kombëtar, por edhe si një shembull për t'u aplikuar edhe në shumë shtete të tjera në zhvillim.

- Në dallim nga periudha e mëparshme e monitorimit, në këtë stad, media ka bërë përpjekje për të trajtuar tema më profesionale në çështjet e reformës në drejtësi, sesa thjesht pasqyrimin e deklaratave dhe pozicioneve politike të aktorëve politikë. Për rrjedhojë, vihet re një qëndrim më i ekuilibruar dhe më me pak ndikime politike të mediave në raport me studimet e kaluara. Arsye për këtë është edhe përfshirja më e madhe dhe më e drejtpërdrejtë e subjekteve ndërkombëtare në mbështetje të reformës në drejtësi.

Partitë politike dhe liderët kryesorë politikë kanë zhvilluar një ligjërime të personalizuar dhe me kurbë në rritje mbi temën e reformës në drejtësi në muajt e marrë në studim. Tipar i ri i kësaj periudhe është përfshirja e drejtpërdrejtë dhe me tone kritike ndaj reformës në drejtësi e Presidentit të Republikës. Ky veprim përfshiu në debat përfaqësuesit e mazhorancës, opozitës dhe kryesisht përfaqësuesit ndërkombëtarë, të cilët kanë qenë vazhdimisht në mbështetje të reformës në drejtësi.

Mazhoranca vijon ta trajtojë reformën në drejtësi si premtim i saj politik dhe si rezultat i vendimmarrjeve të saj politike, duke refuzuar kritikën dhe duke identifikuar veten me reformën. Forma të tilla ligjërime më shumë e dëmtojnë sesa e ndihmojnë procesin e jetësimit të reformës, pasi debate të tilla i japin asaj konotacion politik.

- Partitë kryesore opozitare vijojnë të akuzojnë mazhorancën për kapje politike të procesit të vettingut dhe reformës në drejtësi, duke krijuar idenë se reforma nuk ka arritur pritshmëritë dhe as standardet e kërkuara. Pafuqia e opozitës për të bërë dallimin midis zhvillimeve pozitive dhe kritike në reformën në drejtësi ka krijuar perceptimin se ajo është kundër saj, gjë që dëmton besimin tek efektet afatgjata të reformës.
- Në mediat televizive “Top Channel”, “Klan TV”, “Vizion Plus”, “Ora News”, “News 24”, vihet re një reduktim i debateve mbi temën e reformës në drejtësi. Në medianë e

shkruar; “Panorama“, “Shekulli“, “Gazeta Shqiptare“, “Dita“, dhe në disa portale online; “Javanews.al“, “Politiko.al“, “Syri.net“, etj, është reduktuar ndjeshëm ligjërimi mbi temën e reformës në drejtësi. Zhvendosja e procesit të reformës në një aspekt teknik implementues dhe zhvillimet politike kanë ulur ndjeshëm interesin ndaj kësaj teme.

- Të dhënat e monitorimit tregojnë në tërësi se edhe në këtë raport të katërt ka një mungesë të njohurive të thelluara të koncepteve bazë të reformës në drejtësi, të vettingut dhe të elementëve thelbësorë të reformës, nga një pjesë e subjekteve të monitoruara në këtë studim. Kjo gjë mbështetet edhe me aspektin e ri monitorues me gjetjen kryesore: mungesën e referimit të kuadrit ligjor në temën e reformës.
- Faktori ndërkombëtar mban peshën më të rëndësishme në ligjërimin publik dhe politik mbi reformën në drejtësi, krahasuar me palët politike, shoqërinë civile, institucionet publike dhe deklaratat e ekspertëve.
- Reforma në drejtësi si një proces reformues po ndikon, jo vetëm në procesin legjislativ dhe në gjyqësorin në tërësi, por gjithashtu në çdo sektor publik dhe veçanërisht tek kultura politike e shoqërisë shqiptare duke krijuar në të ardhmen institucione ku qytetarët mund të kenë më shumë besim. Rritja e besimit tek institucionet do të rrisë ndjeshëm besimin e njerëzve ndaj njeri tjetri duke ndikuar te zhvillimi i përgjithshëm i shoqërisë. Ndaj është e nevojshme që përtej interesave të ngushta e afatmesme, reforma në drejtësi duhet të vlerësohet si një objektivi i përbashkët kombëtar i të gjithë shoqërisë dhe institucioneve shqiptare.
- Reforma në drejtësi ishte tema kryesore e debatit politik dhe publik gjatë vitit 2018, por u bë tema e dytë dominuese gjatë gjysmës së parë të vitit 2019 për shkak edhe të krizës politike në vend. Fokusimi i debatit në temën e Anti KÇK, gjendja e emergjencave civile, mos hapja e negociatave për në BE ka zbehur interesin mediatik mbi temën e reformës në periudhën shtator – dhjetor 2019, por është rikthyer në dy muaj e fundit studimor (Janar – Shkurt) si arsye e përfshirjes së Presidentit të Republikës në një ligjërim që lidhet ngushtë me sistemin e drejtësisë.
- Gjatë vitit 2018, aktorët politikë vendorë ishin dominues në deklaratimet mbi reformën në drejtësi, kryesisht përmes ligjërimin politik në parlament, ndërkohë që më 2019 dhe fillim i vitit 2020 peshën kryesore të ligjërimin politik mbi reformën e ka mbajtur faktori ndërkombëtar. Reforma vijon të ketë mbështetjen e fortë ndërkombëtare, sidomos të SHBA dhe të Bashkimit Evropian kjo gjë vihet re edhe nga shpeshësia më e madhe e tyre e ligjërimin të temës së reformës krahasimisht me subjektet e tjera referues.

- **Ndryshimi më i rëndësishëm në procesin e reformës ishte krijimi në dhjetor 2018 i institucioneve të reja kryesore të drejtësisë (KLGJ, KLP, KED, etj) të cilat gjatë vitit 2019 u bënë pikë referimi në raportimet mediatike mbi reformën në drejtësi. Aktiviteti dhe vendimmarrja e tyre zhvendosën vëmendjen e medias dhe publikut nga procesi i vettingut. Së fundmi vëmendja mediatike mbi temën e reformës është rritur prej përfshirjes më të drejtpërdrejtë të Presidentit të Republikës duke pasur kundërshti edhe me institucionet përfaqësuese ndërkombëtare në Shqipëri.**
- **Gjatë periudhës së monitorimit 2018 dhe 2019 nuk janë evidentuar raste serioze kur partitë kryesore apo grupet parlamentare, të kenë iniciuar debate të brendshme profesionale informimi, analize apo reflektimi ndaj zhvillimeve të reformës në drejtësi. Liderit kryesorë politikë vijojnë të kenë bilanc dominues në ligjërimin politik ndaj reformës në drejtësi. Deklaratat e tyre vijojnë të përcaktojnë përmbajtjen e orientuar të ligjërimin politik nga deputetët mbështetës dhe figurat e tjera në partitë politike. Gjatë 2018 dhe 2019 politikanët dhe partitë politike kanë përdorur gjerësisht mediat sociale për të shprehur qëndrimet e tyre në mbështetje apo kritike ndaj reformës në drejtësi. Fokusimi tek mediat sociale është pozitiv në aspektin e transparencës dhe masivitetit, por nga ana tjetër, natyra e vetë mediave sociale është e tillë që më shumë e zhvendos debatin mbi reformën tek linjat partiake si “ushqim për militantët” sesa krijon një këndvështrim horizontal mbi zhvillimet dhe bilancin e saj.**
- **Në krahasim midis dy viteve ka rënie të ndjeshme të numrit të artikujve apo emisioneve dhe raportimeve në bllok apriori refuzuese dhe denigruese ndaj reformës. Më shumë kritikant adresohen në vendimmarrje të posaçme dhe elementë të personalizuar apo të veçuar të reformës në drejtësi sesa në vetë thelbin e procesit të reformës. Gjatë 2019 ka rënie të numrit të debateve televizive që kanë në fokus reformën në drejtësi, kryesisht për shkak të zhvendosjes në prioritetet publike, por edhe për shkak të mungesës së ekspertizës së nevojshme dhe vullnetit pjesëmarrës të ekspertëve të fushës në debate të tilla.**
- **Të dy periudhat e monitorimit tregojnë mungesën e dukshme të njohurive të thelluara të të gjithë aktorëve mbi emërtimet, përgjegjësitë dhe detyrat e institucioneve në drejtësi, për institucionet e reja dhe për ndryshimet kushtetuese në kuadër të reformës të miratuara më 2016. Kjo gjë vihet re edhe në seksionin e fundit monitorues që është risi e studimit aktual, vlerësim i kuadrit ligjor mbi temën e reformës në drejtësi. Dhe nga të dhënat që mund të referohen në pjesën e katërt të studimit subjektet ligjëruese mbi temën e reformës nuk referojnë kuadrin ligjor në temën e reformës në drejtësi.**
- **Gjithashtu vihet re një re një ligjërim i lartë militantesk ose personal mbi temën e reformës në drejtësi. Kryesisht partitë politike dhe institucionet gazetareske me anësi**

politike në analizat e tyre kanë përfshirje militanteske, gjithashtu ligjërimi bazohet më shumë në një debat personal sesa në një debat mbi vetë karakterin themelor të çështjes së reformës në drejtësi.

- Institucionet e reja të drejtësisë kanë qenë të fokusuar në riaktivizimin e sistemit të drejtësisë në kuadër të një destabiliteti si arsye e vettingut të gjyqtarëve. Ndërsa ligjërimi mediatik dhe ai politik është fokusuar gjatë kësaj periudhe mbi vlerësimin e rasteve konkrete që janë futur në procesin e vettingut dhe kanë konkurruar në institucionet e reja të drejtësisë dhe pozicioneve të ndryshme në institucionet e drejtësisë.
- Ligjërimi në nivel parlamentar në këtë periudhë të monitorimit nuk kishte hapësirë për debate dhe kundërshti të shumta, si arsye se opozita ka djegur mandatet parlamentare. Mandatet e reja të opozitës kanë pasur një qasje kritike jo konstante nga mazhorancës në kuadër të ligjëritimit mbi temën e reformës në drejtësi. Subjektet ndërkombëtare vazhdojnë edhe në këtë periudhë monitoruese të insistojnë në vijimësinë e reformës dhe rëndësinë e mbylljes së procesit sa më shpejt të jetë e mundur, duke u përfshirë në takime në politikanë të kaheve të ndryshme dhe drejtuese të institucioneve publike për të përforcuar dialogun në funksion të vijimësisë së reformës në drejtësi. Në këtë periudhë ekspertët e drejtësisë, studiues dhe përfaqësues të shoqërisë civile janë përfshirë më shumë në procesin ligjërues, kryesisht si arsye e vijimësisë së zgjedhjes së drejtuesve në institucionet e reja të drejtësisë kryesisht në periudhën shtator – nëntor 2019.

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Duke u mbështetur te analiza e përgjithshme mbi monitorimin e ligjëritimit politik dhe raportimit mund të propozojmë rekomandimet e përgjithshme si në vijim:

- *Këto të dhëna ose raporte të mund të merren në konsideratë nga politik-bërësit, studiuesit apo edhe mediat e shkruara, vizive apo online, duke i ofruar faktorëve të sipër përmendur mundësinë për të vëzhguar një analizë objektive të vetes së tyre, si një mënyrë për një përmirësim të mundshëm në raport me anshmëritë apo përfaqësimin më objektiv dhe të plotë të temës së reformës në drejtësi.*
- Në planin e raportit të fjalimeve nga politikanët e ndryshëm opozitarë ose në mazhorancë sugjerojmë të zhvillojnë një ligjërim politik dhe publik mbi reformën në drejtësi, jo vetëm në termat e axhendës politike, por duke u thelluar edhe në përmbajtje. Sugjerojmë të mund të ketë një referim më të lartë të kuadrit ligjor në ligjërimin publik dhe politik mbi temën e reformës në drejtësi. Sugjerojmë distancim të

politikës ndaj zhvillimeve të reformës ku njëra palë e konsideron si fitore pa kritika e tjetra si dështim të plotë. Ligjërimi ndaj reformës në drejtësi duhet të jetë një proces konstruktiv në mbështetje të vazhdimit të zbatimit të reformës dhe përmirësimit të mëtejshëm e të kujdesshëm të saj, por në kushtet e një kritike të objektive dhe konstruktive.

- Në nivelin e institucioneve publike sugjerojmë të shmangen deklarata në funksion të ligjërimit partiak. Përfshirja e një ekspertize teknike informuese nga institucionet publike mund të rrisë ndërgjegjësimin qytetar mbi nevojën e zbatimit të mëtejshëm e me prioritet të reformës në drejtësi. Vihet re një ligjërim me karakter personal dhe militantest nga ana e politikanëve. Institucionet e drejtësisë si Gjykata Kushtetuese ose Gjykata e lartë janë ende jo funksionale. Këto institucione garantojnë ekzistencën e shtetit të së drejtës. Sugjerohet të shpejtohet procesi i riaktivizimit të institucioneve jetike të drejtësisë për mirëfunksionimin e demokracinë në Shqipëri, si dhe të plotësohet e të jetë vazhdimisht funksional programi i transparencës i institucioneve të reja të drejtësisë.
- Në nivelin e raportimit mediatik. Në lidhje me mediat televizive “TCH”, “Klan TV”, “Vizion”, “Ora News” , “News 24”, sugjerohet të zhvillohen sesione me karakter informues mbi reformën në drejtësi më shumë sesa debate televizive me të ftuar eksponentë partiakë. Kjo gjë mund të bëhet duke ftuar ekspertë të fushës të cilët mund të qartësojnë më objektivisht qytetarët mbi temën e reformës në drejtësi.
- Në këtë periudhë ligjërimi dominohet nga institucionet dhe ekspertët ndërkombëtar. Ky ligjërim është shtuar në raport me studimin e kaluar duke shkuar në nivelin 35 % të totalit të artikujve. Përfshirja e ambasadës së BE, SHBA dhe Ambasadave të tjera të shteteve evropiane tregon se reforma në drejtësi është në kujdesin dhe prioritet kryesorë të ndërkombëtarëve në shtetin shqiptar. Gjithashtu është shumë pozitive rritja e ligjërimit publik dhe politik mbi temën e reformës nga ana e ekspertëve juridik dhe analistëve të fushës.
- DW dhe Zëri i Amerikës ndryshe nga studimi i kaluar kanë referuar ekskluzivisht më shumë subjekte ligjërues të cilët kanë bërë një kritikë pozitive ndaj reformës në drejtësi. Kjo ndodh pasi referimet më të shpeshta të bëra nga mediat ndërkombëtare në Shqipëri merren nga ligjërimet e subjekteve ndërkombëtar. Subjektet ndërkombëtare kryesisht kanë pasur një kritikë pozitive dhe mbështetëse ndaj reformës në drejtësi.
- Në median e shkruar “Panorama”, “Shekulli”, “Gazeta Shqiptare”, “Dita”, dhe në disa portale online “Javanews.al”, “Politiko.al”, “Syri.net”, etj, ngjashëm me studimin e

kaluar sugjerohet të mos i jepet një rëndësi parësore deklaratave të eksponentëve të ndryshëm partiakë. Vihet re një përmirësim i dukshëm në raport me studimin e kaluar në lidhje me karakterin e analizës në publikimet e mediave të shkruara, pra një shfaqje më e pakët anshmërie mbi temën e reformën në drejtësi. Në nivel të përgjithshëm mediatik sugjerohet një pasqyrim i lajmit pa anshmëri politike.

- **Rekomandim mbi ligjërimin në aspektin e referimit të kuadrit ligjor:** Formati i ligjërimin mediatik është i vështirë që të mund të referohet kuadri ligjor nga ana e subjekteve ligjërues. Formati i ligjërimin ndikon në krijimin e një vështirësie për të referuar kuadrin ligjor të reformës, por megjithatë të dhënat na tregojnë shifra shumë të larta në mungesën e referimit të kuadrit ligjor. Këto shifra na tregojnë se media nuk është një agjent i besueshëm sidomos në aspektin e ligjvënies kjo pasi shpesh flitet për tema me karakter juridik, por nuk citohen akte konkrete juridike. Kjo gjë jep mundësi për një keqinformim të publikut. Në këtë rast sugjerojmë të gjenden forma të ndryshme informimi të dimensionit objektiv të ligjit në media të ndryshme dhe nga subjekte të ndryshme politike.


MONITORIMI I MEDIAVE TELEVIZIVE: GJETJET DHE PROBLEMATIKAT

SHTATOR 2019 - SHKURT 2020

Në periudhën Shtator 2019 - Shkurt 2020, janë monitoruar 5 kanalet kryesore mbi temën e reformës në drejtësi. Monitorimi është bërë në edicionet qendrore të lajmeve si dhe emisionet kryesore politike. Mediat audiovizuale të monitoruara janë: “Top Channel”, “Klan TV”, “News 24”, “Ora News”, dhe “Vizion Plus”.

1. RAPORTIME NË EDICIONE LAJMESH

Në periudhën 6 mujore të monitorimit është llogaritur frekuenca e raportimit të mediave në edicionet e lajmeve. Në total 314 herë është raportuar tema e reformës në drejtësi në edicionet e lajmeve në 5 mediat e monitoruara. Në vendin e parë renditet “Ora News” me 31 % të referimeve. “Vizion Plus” zë 24 % të referimeve, me pas vijon “News 24” me 23 % të referimeve. “Top Channel” zë 12 % të referimeve dhe “TV Klan” zë 10 % të referimeve mbi temën e reformës në drejtësi. “Ora News” dhe “News 24” janë media që kanë si qëllim kryesor transmetimin e lajmeve në pothuajse 24 orë dhe nadj zënë përqindjen më të lartë të referimeve mbi këtë temë.




Në krahasim me studimin e periudhës mars 2019 – gusht 2019, të dhënat e studimit aktual janë pak më të ulëta mbi temën e reformës në drejtësi. Ky është një tregues se interesi mediatic mbi temën e reformës është ulur. Tema e reformës në drejtësi vazhdon të ketë interes në ligjërimin publik dhe mediatic, por si arsye e kalimit nga procesi i rregullimit në kuadrin ligjor në atë kryesisht implementues teknik, tema ka një ligjërim më të pakët.

2. DEBATET TELEVIZIVE DHE INTERVISTA


TV “Ora News” dhe “Klan TV” kanë një përqindje më të lartë referimesh ose dedikim emisionesh ekskluzive mbi temën e reformës në drejtësi. Debatet televizive të “Ora News” mbajnë rreth 43 % të hapësirës mediatike nga 5 mediat e studiuara. “Klan TV” zë 19 % të hapësirës mediatike me emisionin Opinion. Tre mediat kanë përfshirë më pak temën e reformës në drejtësi në emisione televizive “Vizion Plus” rreth 13 %, News 24 zë 9.5 % dhe Top Channel rreth 16 %.

REFORMA NË DREJTËSI NË EMISIONET TELEVIZIVE NË TOTAL



Në tabelën e mëposhtme mund të referohemi në mënyrë më të specifikuar mbi debatet televizive mbi temën e reformës në drejtësi në numra. Debatet mbi temën janë ndarë në ato emisione ku tema e reformës krijon një ligjërim ose debat, por nuk është temë ekskluzive e emisionit dhe emisione ku tema e reformës në drejtësi është ekskluzive. Në krahasim me 6 mujorin e mëparshëm studimor intervistat dhe debatet mbi temën e reformës në drejtësi janë shtuar në një nivel modest. Arsyeja e kësaj ndodhie është përfshirja më e lartë e Presidentit të Republikës në debat kryesisht në muajt shator – tetor 2019 dhe Janar – mars 2020.

Media me më shumë emisione ekskluzive është Ora News me 12 të tilla. Klan Tv nëpërmjet emisionit Opinon krijon ligjërim dhe debat mbi temën e reformës në drejtësi ekskluzivisht 5 herë. Top Channel rrit numrin e emisioneve ekskluzive mbi temën e reformës në periudhën 4 mujore të monitorimit, me 10 emisione ekskluzive. Vizion Plus dhe News 24 zën një hapësirë më të pakët mediatike me ekskluzivitet temën e reformës në drejtësi.




MONITORIMI I MEDIAVE ONLINE DHE GAZETAVE SHTATOR 2019 –SHKURT 2020: GJETJET DHE PROBLEMATIKAT

1. MONITORIMI I MEDIAVE ONLINE

Në periudhën shtator 2019 – shkurt 2020 është bërë një monitorim i përmuajshëm i mediave online dhe gazetave. Të dhënat janë mbledhur për një periudhë 6 mujore. Janë akumuluar të dhëna parësore nga 10 media të ndryshme, 6 media online dhe 4 gazeta periodike. Mediat ndërkombëtare të monitoruara janë “Zëri i Amerikës” dhe “Deutsche Welle”. Të dhënat janë analizuar në mënyrë krahasimore nëpërmjet metodave cilësore dhe sasore. Mediat e shkruara të monitoruara janë: “Panorama”, “Shekulli”, “Gazeta Shqiptare”, “Dita”. Portale online të monitoruara janë: “Javanews.al”, “Politiko.al”, “Syri.net”, “Zëri i Amerikës” etj.

Analiza është përqendruar mbi frekuencat e publikimit të artikujve dhe analizave mbi temën e reformës në drejtësi, muaji i monitorimit, frekuenca e qëndrimeve të institucioneve gazetareske dhe të subjekteve referuese. Kriteri i përzgjedhjes së një analize ose artikulli është bazuar në etikën gazetareske dhe vlefshmërinë e artikullit në kuadrin e një analize pozicionuese, si kritikë pozitive, negative apo objektive ndaj reformës. Të gjitha mediave i është dhënë e njëjta rëndësi në grumbullimin e të dhënave, pavarësisht se disa prej tyre rezultojnë të kenë më pak artikuj të përzgjedhur për analizë.

1.1 Muaji i Monitorimit



Mediat e monitoruara në raport me njëra tjetrën kanë numër referimesh të ndryshme mbi temën e reformës në drejtësi. Në totalin e të dhënave vihet re një referim më i shpeshtë në muajin **nëntor**. 28 % e deklaratave ligjëruese mbi këtë temë janë bërë në vetëm një muaj. Si mazhoranca dhe opozita janë përfshirë në ligjërimin mbi rivënien në punë të Gjykatës

Kushtetuese dhe procesin e zbatimit të drejtësisë nëpërmjet Vettingut dhe SPAK. Përpos rritjes së debatit në këtë muaj specifik nga ana e subjekteve të politikës shqiptare, përsëri faktori ndërkombëtar mbizotëron ligjërimin mbi temën e reformës në drejtësi. Kryesisht vihet re një shpeshti shumë e madhe nga ana e ambasadorëve të BE dhe ShBA duke vlerësuar dhe promovuar procesin e reformës në drejtësi. Në këtë muaj është rritur gjithashtu ligjërimi në temën e krijimit të organeve të reja të drejtësisë.

Muaji me më pak artikuj të cituar është **dhjetori** me 11 % nga totali i artikujve për 6 muaj. Janë dy arsye pse ligjërimi mbi reformën është ulur në dhjetor. Së pari, pas fatkeqësisë natyrore të ndodhur në datën 26 nëntor 2019, fokusi mediatik dhe politik u fokusua te kjo emergjencë civile-natyrore. Së dyti me ardhjen e festave të fund vitit ligjërimi mediatik mbi çështjet publike dhe politike u ul në tërësi.


Në 4 muajt e tjerë ligjërimi mbi temën e reformës në drejtësi ka qenë pothuajse i barabartë. Në muajin **shtator dhe tetor** fokusi i ligjërimin politik dhe mediatik ishte mbi tematikën e mos hapjes së negociatave për Shqipërinë në Bashkimin Evropian. Reforma në Drejtësi është referuar në mënyrë të pjesshme si një nga arsyet kryesore të mos hapjes së negociatave. Reforma në drejtësi dhe vettingu janë konsideruar si procese të ngadalta dhe kanë krijuar një ngërç në sistemin e drejtësisë, duke pamundësuar punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të lartë. Çështja “Tahiri” ka sjell një pakënaqësi edhe nga institucionet ndërkombëtare në lidhje me efikasitetin e institucioneve të reja të drejtësisë.

Në muajt **Janar dhe Mars** fokusi i ligjërimin është vendosur mbi bisedat e institucioneve ndërkombëtare në Shqipëri me përfaqësues të institucioneve publike dhe politikanë të kaheve të ndryshëm. Ngritja e platformës Anti KÇK gjithashtu ka hasur në shumë polemika dhe diskutime, duke u kritikuar nga ana e palës opozitare si kapje e sistemit të drejtësisë nga mazhoranca.

1.2 Raportime mbi reformën në media

Të dhënat e të gjithë mediave online dhe gazetave janë vendosur në një matricë për të krahasuar nivelin e shpeshtisë së referimeve të të gjithë mediave. Nëpërmjet këtyre të dhënave mund të veçojmë median që ka pasur një ligjërim më të madh në temën e reformës në drejtësi. Pavarësisht se nëpërmjet këtyre të dhënave mund të krahasojmë këto media në raport me njëra tjetrën, mund të paraqitet edhe fakti se ligjërimi mbi temën e reformës në drejtësi është ulur shumë në krahasim me raportin e studimit mbi të njëjtën temë për periudhën mars 2019 – gusht 2019. Numri i referimeve të grumbulluar nga procesi monitorues është rreth 200 për 10 mediat e monitoruara për periudhën studimore shtator 2019 – mars 2020 dhe rreth 350 referime për periudhën studimore 6 mujore mars 2019 – gusht 2019. Nëpërmjet këtyre të dhënave vihet re një ulje e interesit mediatik dhe politik mbi temën e reformës në drejtësi.

Arsyet për këtë gjë janë të shumta. Fokusi i ligjërimit është orientuar më shumë në temën e reformës zgjedhore, gjendjes së jashtëzakonshme me tërmetet e nëntor – dhjetorit 2019.



Numrin më të lartë të raportimeve e ka portali “Javanews.al” me 18.8%, në vendin e dytë është media “Tema.net” me 15.84%. Ndërsa media me përqindjen më të ulët është “DW” me 1.49%. Referime të tjera jo të ulëta mbi temën e reformës në drejtësi për periudhën monitoruese shtator 2019 – mars 2020 janë Zëri i Amerikës me 3.47%, Gazeta Dita dhe portali syri.net me nga 9.41% të referimeve ligjëruese.


Në krahasim me monitorimin e 6 mujorit të parë vihet re ulje e referimeve në total tek pothuajse të gjithë mediat. Së dyti rezulton një media e re me më shumë referime. Javanews në studimin aktual me 18.81% të referimeve dhe 16.51% në studimin e kaluar. Ndërkohë portali Tema kalon në vendin e dytë në nivel referimesh me 15.84% dhe në studimin e kaluar mbante vendin e parë të referimeve me 22.43 % të referimeve ligjëruese mbi temën e reformës në drejtësi.

Duke përjashtuar mediat ndërkombëtare, portalet mediatike online kanë numër më të madh publikimesh mbi temën e reformës në drejtësi, “Tema”, “Syri”, “Politiko” dhe “Javanews”. Ndërsa mediat e shkruara zënë një përqindje më të ulët në krahasim me portalet online. Kjo vjen si arsye se nga vetë natyra e mediave online logjistika është më lehtësuese në publikimin sa më të shpeshtë dhe të menjëhershëm të informacionit në krahasim me gazetatat. Një arsye e dytë është fakti se në gazeta artikujt kanë një karakter më analitik, ndërsa në portale më shumë një karakter më informues.

2. QËNDRIMI I MEDIAVE

2.1 Qëndrimi i mediave në total


Në këtë pjesë të studimit kemi nxjerrë të dhënat mbi qëndrimin e vetë mediave mbi temë e reformës në drejtësi. Në këtë aspekt përjashtojmë qëndrimin e subjekteve të tjera ligjëruese si politikanë, subjektet ndërkombëtare, ekspertë etj. Duke qenë se pjesa më e madhe e subjekteve ligjëruese kanë një dakordësi jo të hapur mbi mbështetjen në parim mbi reformën në drejtësi, ajo që do analizohet është lloji i qasjes ligjëruese ndaj reformës. Si kritikë pozitive, kritikë negative apo kritikë objektive. Me kritikë pozitive kuptojmë qasjen kryesisht pozitive ndaj reformës në drejtësi, një lloj prirje subjektive pozitive ndaj reformës. Për kritikën negative mund të themi të njëjtën gjë. Ndërsa me kritikë objektive i referohemi një mungese subjektivizmi në ligjërime, qoftë nëse ligjëruesi e kritikon pozitivisht apo negativisht.



Shkencat e komunikimit dhe gazetarisë nga raportimi pritet që qëndrimi i tyre të jetë më shumë me orientim objektiv ose të papërcaktuar mbi një temë të caktuar. Diferenca mes qëndrimi objektiv dhe i papërcaktuar lidhet me faktin se në kritikën objektive bëhet një vlerësim nga ana e medias mbi reformën, ndërsa në rastin “i papërcaktuar” media ka thjesht një qëndrim informues. Pavarësisht se media mund të ketë qëndrim informues të papërcaktuar, subjektet ligjërues të referuar nga media mund të kenë kritikë objektive, pozitive ose negative. Për një media ruajtja e një qëndrimi informues ose objektiv ndaj një teme të caktuar është qëllimi i tyre primar, pasi qëllimësia e institucioneve gazetareske është objektivizmi në raportimin e lajmit.


Duke iu referuar tabelës së mësipërme “Qëndrim i papërcaktuar” haset më shpesh me 64 % të të dhënave, një dukuri shumë pozitive kur media ruan një qasje informuese ose objektive në raportimin e lajmit. Bashkë qëndrimi informues “i papërcaktuar” dhe objektiv zë 72 % të totalit të të dhënave. Kritika negative zë 9.41 % të të dhënave. Kritika pozitive në temën e reformës në drejtësi reflektohet me 19 % të të dhënave. Vihet re një orientim më shumë pozitiv ndaj reformës në drejtësi në periudhën studimore 6 mujore shtator 2019 – mars 2020 ku kritika pozitive është rritur nga 11 % në studimin e kaluar në 19 % në studimin aktual. Dhe kritika negative është ulur nga 16 % në studimin e kaluar në 9.41 % në studimin aktual. Këto të dhëna tregojnë se ligjërimi i vetë mediave të cilat kanë pasur një kritikë kryesisht negative kanë ulur pak ligjërimin e tyre kritikues ndaj reformës duke pasur një qasje më shumë objektive ose informuese ndaj reformës.

2.2 Qëndrimi mediatik (Media online)



Media online në total. Në tabelën e mësipërme paraqiten rezultatet e të dhënave në përqindje nga 6 mediat online të monitoruara në periudhën shtator 2019 – mars 2020. Në mediat online të monitoruara vihet re një qëndrim kritike kryesisht pozitive ndaj reformës në drejtësi. Rreth 27 % kritikë pozitive dhe rreth 13 % kritikë negative. Arsyeja pse kemi një rritje të kritikës pozitive nga ana e mediave në portalet online është pasi shumë prej mediave me një orientim ligjërues kritike negative kanë zhvendosur ligjërimin e tyre drejt raportimit objektiv ose informues mbi temën e reformës në drejtësi. Së dyti interesi për temën e reformës është ulur në këtë periudhë të marrë në studim, pra pothuajse janë përgjysmuar ligjërimet mbi këtë temë në mediat e monitoruara.

Mediat online, të specifikuar. Në këtë pjesë të analizës do të krahasojmë qëndrimin e secilës prej portaleve online në raport me vetveten dhe jo në total me portalet e tjera. Nëse qëndrimi i papërcaktuar shënon zero dhe qëndrimi kundër ka një përqindje thuhet aspak të rëndësishme, rrjedhimisht qëndrimi i këtij institucioni gazetaresk është i politizuar, shënuar nga një përqindje e lartë e qëndrimit pro reformës në drejtësi. Të njëjtën gjë mund të themi në lidhje me kritikën negative nëse shënon një përqindje të konsiderueshme, kur kritika pozitive është afër 0-os.



Media të cilat janë kryesisht të pozicionuara **me kritikë pozitive** në shumicën e artikujve të tyre janë “Tema” me 68.75 % dhe “Javanews” me rreth 29 %. Media “Tema” ka një qëndrim kritike pozitive më të lartë se në 6 mujorin e parë studimor, pasi nga 15 % e artikujve me kritikë pozitive ka shkuar në rreth 68.75 % kritikë pozitive. Këto dy media rezultojnë edhe në studimin e kaluar me një kritikë pozitive ndaj reformës në drejtësi.


Media të cilat janë kryesisht të pozicionuar me **kritikë negative** ndaj reformës në shumicën e artikujve të publikuar janë “Syri.net” 63.16 %, dhe “Politiko.al” me 14.29 %. Në rastin e “Syri.net” është i dukshëm qëndrimi i një kritike negative ndaj reformës në drejtësi, ndërsa në rastin e “Politiko.al” e kuptojmë kritikën e tyre kryesisht negative, pasi kritika e tyre pozitive ndaj reformës është 0 %. “Syri.net” qëndron ende i pozicionuar qartësisht kundër reformës në drejtësi nga perceptimi i nxjerr prej shkrimeve të redaksisë dhe pozicionimeve të redaksisë në artikuj. Ky portal edhe në studimin e mëparshëm kishte përqindjen më të lartë si pozicionim kundër reformës në drejtësi.

Media e cila shfaq një kritikë **objektive** është “Zëri i Amerikës” me 100% të artikujve të referuar. Nga këto të dhëna arrijmë në konkluzion se mediat ndërkombëtare nga portalet online janë të vetmet me një qëndrim kryesisht objektiv kundër reformës në drejtësi. “Syri.net” mund të veçohet si media, që ka pasur një orientim të dukshëm më shumë kritike negative ndaj reformës në drejtësi. Tek “Javanews” vihet re një kritikë kryesisht pozitive ndaj reformës në drejtësi.


2.3 Qëndrimi mediatik (Gazeta)

Gazeta në total. Nga të dhënat e grumbulluara dhe artikuluara sipas grafikut të mëposhtëm mund të vëmë re se qëndrimi i gazetave në ligjërim është më afër qëndrimit autentik objektiv dhe qëndrimit me karakter informues krahasuar me mediat online. Vihet re një qëndrim i papërcaktuar mbi reformën në drejtësi tek 4 gazetatat të marra në studim në nivelin 84 %. Ky rezultat na tregon se gazetatat e shkruara kanë një qasje më së shumti informuese ndaj ligjëritimit mbi temën e reformës, në krahasim me mediat online. Kritika pozitive dhe negative e vetë mediave gazetareske është e papërfillshme në përqindje për të krijuar supozime nëse këto gazeta kanë anshmëri politike në temën e reformës në drejtësi.

Gazetat, të specifikuar. Duke analizuar të dhënat mbi qëndrimin e gazetave në raport me vetveten kemi gjetje të tjera të cilat na japin mundësinë për supozime mbi anshmëri të mundshme të këtyre mediave mbi temën e reformës në drejtësi. Media të pozicionuara me **kritikë pozitive** ndaj reformës në shumicën e artikujve të tyre në studimin e katër gazetave nuk ka. Gjithashtu as media të pozicionuara qartazi me një kritikë negative nuk ka.



Media të cilat shfaqin një qëndrim të papërcaktuar, pra më shumë informues janë “Gazeta Shekulli” me 96 %, “Panorama” me 81 % dhe “Dita” me 95 %. Nga këto të dhëna kuptojmë se tre nga mediat e shkruara, gazeta periodike kanë shfaqur një qëndrim gazetaresk relativisht objektiv. Gazetat Dita, Panorama dhe Shekulli kanë një ligjërim pothuajse të papërfillshëm me kritikë pozitive ose negative ndaj reformës në drejtësi.



Ndërsa Gazeta Shqiptare kanë një raport pothuajse të balancuar mes të 4 qëndrimeve. Këto të dhëna na tregojnë se ekziston një pasqyrim më objektiv informues gazetaresk nga ana e medias së shkruar fizike (gazeta), në krahasim me atë elektronike (portale online). Kjo ndodh si arsye se


në median e shkruar fizike i dedikohet më shumë hapësirë zhvillimit të një teme të caktuar. Synimi i gazetave fizike është informimi sa më i detajuar mbi lajmin, ndërsa në portalet online synim kryesor është nxjerrja sa më e shpejtë dhe e shpeshtë e lajmit. Kjo e fundit ndikon në objektivizmin e temës si arsye e kohës së dedikuar për kërkimin dhe formatin e shkrimit të lajmit.

2.4 Qëndrimi i mediave (Media Online Vs Gazeta)

Në këtë pjesë të studimit do të vendosen në raport mes mediave online dhe gazetave të katër qëndrimet vlerësuese mbi temën e reformës në drejtësi. Në lidhje me qëndrimin informues “të papërcaktuar” raporti gazeta dhe media online është shumë afër 50 %-it në të dy rastet. Ndërsa në lidhje me të dhënat mbi tre qëndrimet e tjera vlerësuese (kritikë pozitive, negative dhe objektive) vihet re një përqindje më e lartë nga ana e portaleve në raport me gazetatat.

Portalet kanë rreth 90 % të referimeve me kritikë pozitive në raport me gazetatat dhe rreth 85 % të kritikave negative në raport me gazetatat. Gjithashtu edhe mbi kritikën objektive referimet më të shpeshta rreth 69 % janë bërë nga portalet online.

Arsyeja pse të dhënat janë më të larta të portaleve online në raport me gazetatat është pasi portalet online kanë bërë më shumë referime ligjëruese mbi temën e reformës në drejtësi krahasimisht me gazetatat. Kjo gjë është e pritshme duke marrë parasysh se lajmet në portalet online kanë më shumë lehtësi logjistike për tu publikuar në gazetatat e përditshme me printim fizik.



3. FJALIMET NË RAPORT ME REFORMËN NË DREJTËSI – SUBJEKTET LIGJËRUES

3.1 Subjektet ligjërues në të gjithë mediat


Mediat e monitoruara (6 portale online dhe 4 gazeta) kanë referuar mbi 200 herë temën e reformës në drejtësi. Në këto referime mund të vihet re qëndrimi i vetë medias mbi reformën në drejtësi, rezultatet e të cilave janë paraqitur në pjesën e mësipërme të studimit. Gjithashtu këto media të monitoruara kanë paraqitur ligjërimin e subjekteve të ndryshme dhe në vetëm pak raste ligjërimi ishte ekskluziv i vetë institucionit mediatik. Cilat janë këto subjekte ligjëruese në mediat e monitoruara? Këto subjekte ligjërues janë: institucionet ndërkombëtare, institucionet publike, organizata ose ekspertë ndërkombëtarë, politikanët e mazhorancës dhe të opozitës, OJF & shoqëri civile, gazetarë & ekspertë të ndryshëm dhe gjithashtu vetë institucioni mediatik. Qëndrimet e këtyre subjekteve janë analizuar mbi të njëjtin parim kërkimor, duke vlerësuar nëse kanë qëndrim kritike pozitive, negative apo objektive.

Tema e reformës në drejtësi është mbuluar si lajm duke u bazuar më shumë te deklaratat ose raportet e institucioneve ndërkombëtare, ambasada, etj, me rreth 36 % të totalit të ligjërimeve. Politikanët e mazhorancës dhe opozitës së bashku mbajnë rreth 29 % të totalit të ligjërimeve. Nga të dhënat vihet re se politikanët e mazhorancës dhe opozitës kanë zënë një ligjërim të barabartë në nivel mediatik në raport me njëra tjetrën me rreth 14 % politikanët e opozitës dhe rreth 16 % politikanët e mazhorancës.

Rreth 10 % të referimeve janë deklaratat ose raportet e institucioneve publike. Në këtë sektor përfshihen institucioni presidencial, ministritë e ndryshme dhe organet kompetente të gjyqësorit. Vihet re gjithashtu një referim në rreth 15 % të artikujve ose analizave të gazetarëve, ekspertëve juridikë ose studiuesve politikë dhe 2 % të OJF & shoqërisë civile, shifra këto jo fort pozitive për një vend i cili ka një sistem demokracie përfaqësuese në zhvillim, ku ndikimi i shoqërisë civile dhe ekspertëve të fushës është shumë i nevojshëm. Vihet re një rritje e ligjërimin të ekspertëve në krahasim me studimin e kaluar nga rreth 11 % të referimeve ka shkuar në 15 % të totalit të ligjërimeve mbi temën e reformës në drejtësi.

Pozitivë është fakti që ligjërimi dominohet nga institucionet dhe ekspertët ndërkombëtar. Ky ligjërim është shtuar në raport me studimin e kaluar duke shkuar në nivelin 35 % të totalit të artikujve. Përfshirja e ambasadës së BE, SHBA dhe Ambasadave të tjera të shteteve evropiane tregon se reforma në drejtësi është në kujdesin dhe prioritet kryesorë të ndërkombëtarëve në shtetin shqiptar. Gjithashtu është shumë pozitive rritja e ligjërimin publik dhe politik mbi temën e reformës nga ana e ekspertëve juridik dhe analistëve të fushës.

SUBJEKTET LIGJËRUES




3.3 Subjektet ligjërues në mediat online

Në këtë pjesë të studimit do të shfaqet qëndrimi i kritikës pozitive, negative, ose objektive në raport me reformën në drejtësi për secilën media më vete. Duke vlerësuar qëndrimin e ekspertëve ligjërues në total në një media specifike me kritikën që ka ndaj reformës në drejtësi mund të supozojmë një lidhje pse një media e caktuar përzgjedh një ekspert ligjërues i cili ka anshmëri në gjykim. Mund të kuptojmë nëse institucionet gazetareske u referohen ekspertëve të paanshëm politikisht, të njëanshme ose me qëndrim të qartë politik.

Në lidhje me **kritikën pozitive** subjektet ligjërues në “Javanews” kanë kritikë pozitive ndaj reformës në drejtësi me rreth 90 % dhe me vetëm 5 % kritikë negative dhe 5 % kritikë objektive.

Në lidhje me **kritikën negative** subjektet ligjërues në “Syri.net” kanë kritikë negative ndaj reformës në drejtësi me rreth 90 % dhe me vetëm 5 % kritikë pozitive dhe 5 % kritikë objektive. Kjo e dhënë tregon se janë përdorur kryesisht burime reference të cilat janë kundër reformës ose burimet e referencës janë interpretuar kryesisht kundër reformës në drejtësi.



“Tema” dhe “Politiko” kanë një nivel referimesh më të madhe kritike pozitive në raport me atë negative, megjithatë raporti nuk është shumë i skajshëm për të krijuar një lidhje të qartë preference referimi nga ana e këtyre mediave në subjekteve ligjërues që bëjnë kritikë pozitive ndaj reformës në drejtësi.


DW dhe Zëri i Amerikës ndryshe nga studimi i kaluar kanë referuar ekskluzivisht më shumë subjekte ligjërues të cilët kanë bërë një kritikë pozitive ndaj reformës në drejtësi. Kjo ndodh pasi referimet më të shpeshta të bëra nga mediat ndërkombëtare në Shqipëri merren nga ligjërimit e subjekteve ndërkombëtar. Subjektet ndërkombëtare kryesisht kanë pasur një kritikë pozitive dhe mbështetëse ndaj reformës në drejtësi.

Në lidhje me **kritikën objektive** vetëm DW ka pasur një nivel referimi të subjekteve ligjërues me kritikë kryesisht objektive ndaj reformës në drejtësi, ndërsa mediat e tjera online kanë pasur kryesisht një anësi pozitive ose negative në referimin e subjekteve ligjërues. Gjithashtu vihet re një përfshirje më e madhe e mediave të huaja në Shqipëri si “Zëri i Amerikës” dhe “Deutsche Welle”. Duke qenë se deklaratat e ndërkombëtarëve në lidhje me reformën në drejtësi janë rritur në këtë periudhë, rrjedhimisht edhe mediat e huaja në Shqipëri kanë rritur nivelin e pasqyrit të këtyre institucioneve në nivel ndërkombëtar për reformën në drejtësi.

3.4 Subjektet ligjërues në gazeta

Në këtë seksion do të vlerësojmë nëse institucionet gazetareske pasqyrojnë referime ekspertize të paanshme politikisht, të njëanshme ose të një qëndrimi të qartë politik. Në këtë seksion janë marrë në studim 4 gazeta periodike të shkruara. Tabela e mëposhtme pasqyron të dhënat në përqindje të secilës media, nëse janë pozicionuar me kritikë pozitive, negative apo objektive.

Në lidhje me **kritikën pozitive** ekspertët në gazetën “Dita” shfaqin një kritikë pozitive ndaj reformës në drejtësi me 84 % dhe vetëm 5 % kundër. Kjo e dhënë tregon se janë përdorur burime reference të cilat kanë kritikë pozitive ndaj reformës ose burimet e referencës janë interpretuar kryesisht pozitivisht ndaj reformës në drejtësi.



Në lidhje me **kritikën negative** ekspertët në “Gazetën Shqiptare” ndaj reformës në drejtësi kanë 50 % të të dhënave, por kjo shifër bëhet e parëndësishme pasi përqindja e tyre e referimit të ekspertëve pro është 37 %. Kjo e dhënë e fundit na tregon se “Gazeta Shqiptare” ka referuar në mënyrë të përafërt ekspertë që i përkasin sa kritikës pozitive, po aq edhe negative. Gjithashtu “Shekulli” dhe “Panorama”, kanë relacion të përqindjeve shumë të afërt mes kritikës pozitive dhe asaj negative.


Në lidhje me **qëndrimin asnjanes ose të papërcaktuar** të dhënat e mësipërme pro ose kundër zënë pjesën më të madhe të referimeve, ndërsa qëndrimet të papërcaktuar kanë një referim shumë afër minimumit në të katër gazetat.

3. REFERIMI I LIGJIT NË LIGJËRIME

Në totalin e të dhënave mbi subjektet ligjëruese në të 10 mediat e monitoruara në këtë pjesë të studimit është vlerësuar nëse kuadri ligjor mbi temën e reformës në drejtësi është referuar në këto ligjërata. Gjithashtu është vlerësuar karakteri i tyre ligjërues, nëse ligjërimi ka karakter ligjor, personal, militantesk etj.

3.1 Referim i kuadrit ligjor


Referimi i kuadrit ligjor në total. Subjektet ligjërues përpos përcaktimit të karakterit të llojit të ligjërimin pozitiv, negativ apo objektiv ndaj reformës në drejtësi janë vlerësuar nëse kanë referuar kuadrin ligjor të reformës në drejtësi në ligjërimet e tyre. Në të dhënat e mëposhtme pasqyrohet rezultati i totalit të dhënave të të gjithë subjekteve ligjëruese dhe të të gjithë mediave të monitoruara.



Nga të dhënat shfaqen rezultate të rëndësishme mbi referimin e kuadrit ligjor. Rreth 76 % të ligjërimeve nuk referojnë në asnjë aspekt të ligjërimin të tyre kuadrin ligjor të reformës në drejtësi. Rreth 24 % të ligjërimeve referojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose pjesërisht të

drejtpërdrejtë kuadrin ligjor të reformës në drejtësi. Njëpërmjet këtyre të dhënave kuptojmë se ligjërimi publik dhe politik mbi temën e reformës në drejtësi nuk referon kuadrin ligjor, por është më së shumti i bazuar në opinione personale, prirje politike militanteske ose prirje politike apriori vlerësuese ose kritikuese ndaj temës së reformës në drejtësi. Në një vend me demokraci zhvilluese është e nevojshme që kuadri ligjor të jetë pjesë themelore e ligjërimin politik, pasi përndryshe trendet e demokratizimit varen nga opinionet dhe interesat e subjekteve të ndryshme politike.

Referim i kuadrit ligjor sipas subjekteve ligjërues. Pavarësisht se në totalin e të dhënave vihet re kryesisht një mungesë referimi të ligjit në ligjërimin mbi temën e reformës në drejtësi, nëse këto të dhëna i ndajmë sipas subjekteve ligjërues në mënyrë të mëvetëshme mund të kemi të dhëna edhe më domethënëse mbi ligjërimin në përgjithësi.



Politikanët e Opozitës në 100 % të ligjëtimeve të tyre në mediat e monitoruara nuk kanë referuar kuadrin ligjor të reformës në drejtësi, Politikanët e mazhorancës nuk e kanë referuar kuadrin ligjor në 83 % të referimeve. Institucionet gazetareske (mediatike) nuk kanë referuar kuadrin ligjor në 71.43 % të referimeve. Ekspertët dhe institucionet ndërkombëtare nuk kanë referuar kuadrin ligjor në 90 % të referimeve. Këto të dhëna na tregojnë se politikanët e mazhorancës dhe opozitës nuk e mbështesin ligjërimin e tyre politik në kuadrin ligjor, kjo pasi

nevojitet një ligjërim kryesisht militantesk për të mbështetur argumentet politike nga ana e tyre. Institucionet mediatike gjithashtu nuk referojnë kuadrin ligjor, por mbështesin ligjërimin e tyre nëpërmjet argumenteve politike, personale ose militanteske. Ndërsa institucionet ndërkombëtare si arsye se kanë marrë një qëndrim mbështetës apriori mbi temën e reformës në drejtësi si iniciator të kësaj reforme zakonisht bëjnë thirrje për zhvillimin e mëtejshëm të reformës, sukseset e reformës dhe rritjen e besueshmërisë në të. Ndaj edhe referimi i kuadrin ligjor është i paktë nga ana e institucioneve dhe ekspertëve ndërkombëtar. Format i ligjërimin mediatik është i vështirë që të mund të referohet kuadrin ligjor nga ana e subjekteve ligjërues. Format i ligjërimin ndikon në krijimin e një vështirësie për të referuar kuadrin ligjor të reformës, por megjithatë të dhënat na tregojnë shifra shumë të larta në mungesën e referimit të kuadrin ligjor. Këto shifra na tregojnë se media nuk është një agjent i besueshëm sidomos në aspektin e ligjvënies, kjo pasi shpesh flitet për tema me karakter juridik, por nuk citohen akte konkrete juridike. Kjo gjë jep mundësi për një keqinformim të publikut. Në këtë rast sugjerojmë të gjenden forma të ndryshme informimi të dimensionit objektiv të ligjit në media të ndryshme dhe nga subjekte të ndryshme politike.

Subjekt ligjërues të cilët në shumicën e ligjërimeve referojnë temën e reformës në drejtësi janë OJF & Shoqëria Civile me 75 % të referimeve duke u mbështetur në kuadrin ligjor. Gazetarët dhe ekspertët e fushës në rreth 52 % të ligjërimeve referojnë kuadrin ligjor dhe institucionet publike gjithashtu në 38 % të ligjërimeve referojnë kuadrin ligjor. Nga këto subjekte ligjëruese është e pritshme të mund të ketë një objektivizëm dhe referim ligjor mbi temën e reformës, pasi janë subjekte më pak të përfshira politikisht ose institucione përgjegjëse mbi reformën në drejtësi, siç është rasti i institucioneve publike.


1.1 Karakteri i ligjërimin

Në këtë pjesë të studimit është vlerësuar karakteri i ligjërimin të subjekteve ligjërues. Artikujt janë përcaktuar mes 4 llojeve të ligjërimin: Ligjërim me karakter ligjor, personal, militantesk dhe vlerësues & monitorues. Jo të gjithë ligjërimin kanë qenë me karakter ekskluzivisht personal, militantesk apo vlerësues dhe monitorues. Një pjesë e ligjërimeve kanë një karakter miks, pra njëkohësisht personal, militantesk dhe vlerësues e monitorues.

Pjesa e madhe e ligjërimeve, 36 % e tyre kanë pasur një karakter vlerësues dhe monitorues. Arsyeja pse ligjërimi ka një karakter kryesisht vlerësues dhe monitorues është pasi pjesa më e madhe e ligjërimeve është bërë nga institucionet ndërkombëtare dhe këto subjekte ligjërojnë mbi reformën në drejtësi në aspektin vlerësues ose monitorues.

Gjetje tjetër e rëndësishme janë ligjërimin e shumta me karakter personal ose militantesk. N.q.s. mbledhim së bashku tipologjitë personal, militantesk dhe personal/militantesk bashkë janë 48 % të ligjërimeve. Pra 48 % e ligjërimeve janë me karakter ekskluzivisht ose miks personal/militantesk. Në këto të dhëna nuk llogarisim përfshirjen e karakterit të ligjërimin personal dhe militantesk në raport miks me dimensionin ligjor ose vlerësues dhe monitorues.

Karakteret e ligjërimit



Me ligjërime kryesisht personal kemi përcaktuar ligjërime të cilat nuk trajtojnë reformën në drejtësi në vetvete, por akuzojnë ose ligjërojnë kundrejt një personi të caktuar nëpërmjet temës së reformës në drejtësi. Ligjërime militantesk kemi përcaktuar ligjërime të politikanëve ose subjekteve të ndryshme të cilat ligjërojnë jo për hir të temës së reformës, por për qëllime propagandistike kritikisht pozitive ose negative ndaj reformës në mënyrë që të mbështesin axhendën e tyre politike në përgjithësi.

Nga këto të dhëna veçojmë karakterin ligjërues vlerësues dhe monitorues të cilën më së shumti e kanë bërë subjektet ligjëruese ndërkombëtare dhe gjithashtu karakterin personal dhe militantesk të cilin si ligjërime e kanë përdorur më së shumti politikanët e mazhorancës, opozitës apo institucione gazetareske të cilat kanë shfaqur dukshme anshmëri politike ndaj temës së reformës në drejtësi.

SHKTOJÇË: DEBATET EKSKLUZIVE NË EMISIONE TELEVIZIVE

“Top Channel”. Në kanalin televiziv “Top Channel” emisioni i monitoruar është “Top Talk”. Në studion e emisionit “Top Talk” të drejtuar nga gazetari Denis Dyrnjaja, ishte i ftuar analisti Andi Bushati. Presidenti i vendit Ilir Meta ka nisur sulme të njëpasnjëshme ndaj mazhorancës duke i akuzuar për organizimin e një grushti shteti. Analisti Andi Bushati shpjegon qëndrimet e presidentit duke ligjëruar mbi temën e reformës në drejtësi, mbi faktin se mungesa e gjykatës kushtetuese dhe gjykatës së lartë po i jep mundësi opozitës të abuzoj me organet e reja të drejtësisë. Në një emision ekskluziv mbi temën e reformës në drejtësi Petrit Vasili shpjegon mbi neglizhencën e SPAK dhe organeve të tjera të drejtësisë.

“Vizion Plus”. Emisioni i monitoruar në këtë media është **“Kapital”** me Aleksandër Furxhi ku në një nga emisionet ekskluzive me të ftuar Spartak Ngjela diskutohet ngërçi me gjykatën kushtetuese dhe reformën në drejtësi.

“News 24”. Emisioni i monitoruar në këtë media është **“Të paeksponuarit”** me Ylli Rakipin. Tema e reformës përmendet në 7 emisione. Temat e emisioneve nuk i kushtohet ekskluzivisht temës së reformës në drejtësi. Vihet re një ligjërim i cili mbështet reformën në drejtësi, por kritikohet implementimi i tij kryesisht në aspektin e organeve të drejtësisë.

“Ora News”. Në Ora News tema e reformës është monitoruar në emisionet “360” dhe “Intervista”. Në emisionin “360” të drejtuar nga Artur Zhei vihet re ekskluziviteti i ligjërimit mbi temën e reformës në drejtësi nxitur nga përplasa e presidentit dhe institucioneve ndërkombëtare mbi këtë temë. Në emisionin “Intervista” në këtë periudhë monitorimi zë hapësirë të konsiderueshme mediatike. Tema e reformës diskutohet në çdo muaj të monitoruar duke marrë në konsideratë edhe temën e ditës. Që nga mos-hapja e negociatave në shtator dhe deklarata e Presidentit Ilir Meta në mars mbi mosrespektimin e kushtetutës dhe kapjen e organeve të drejtësisë nga ana e mazhorancës.

“Klan TV”. Me emisionin **“Opinion”** me gazetarin Blendi Fevziu tema e reformës ka pasur një shpeshti më të lartë në ligjërimit mediatik. Edhe në këtë rast shpeshtia e emisioneve ekskluzive është rritur si arsye e përfshirjes më të lartë dhe më të drejtpërdrejtë të Presidentit të Republikës Ilir Meta në temën e reformës në drejtësi. Në dy emisione Presidenti është ftuar për të folur mbi qëndrimin e tij kundërthënës ndaj mazhorancës dhe institucioneve ndërkombëtare.

